



KOLEGJI FAMA-FAMA COLLEGE



ODA E AVOKATËVE TË KOSOVËS  
ADVOKATSKA KOMORA KOSOVA  
KOSOVA BAR ASSOCIATION


**MEMORANDUM I BASHKËPUNIMIT**  
**në mes të**  
**ODËS SË AVOKATËVE TË KOSOVËS**  
**dhe**  
**Kolegji FAMA**

Me qëllim të ngritjes së bashkëpunimit në mes të Odës së Avokatëve të Kosovës dhe Kolegjit FAMA në Prishtinë, duke qenë të vetëdijshëm për interesat reciproke të të dy institucioneve, që rrjedhin nga vendosja dhe zhvillimi i marrëdhënieve dhe bashkëpunimit, Oda e Avokatëve të Kosovës në Prishtinë dhe Kolegji FAMA lidhin këtë memorandum mirëkuptimi dhe pajtohen të zhvillojnë bashkëpunim në:

- I. Oda e Avokatëve të Kosovës në Prishtinë dhe Kolegji FAMA, pajtohen që për interesa të përbashkëta të asistojnë, promovojnë përkrahin dhe ngrisin nivelin e bashkëpunimit reciprok në mes tyre në funksion të zhvillimit të përgjithshëm të sistemit edukativo-arsimor, hulumtues dhe shkencor.
- II. Oda e Avokatëve të Kosovës në Prishtinë dhe Kolegji FAMA, pajtohen të kontribuojnë në drejtim të zhvillimit, përkrahjes dhe promovimit të sektorit edukativ dhe profesional, ofrimit të shërbimeve përkatëse dhe hapësirën për kryerjen e pjesës praktike për studentët e Kolegjit FAMA nga Oda e Avokatëve të Kosovës në Prishtinë dhe në ofrimin e hapësirës/sallave nga Kolegji FAMA për aktivitete të trajnimeve, takimeve, konferencave për Oda e Avokatëve të Kosovës në Prishtinë.
- III. Oda e Avokatëve të Kosovës në Prishtinë dhe Kolegji FAMA, pajtohen që në përgatitjen e propozimeve dhe realizimin e projekteve të përbashkëta të paraqesin ofertimin e përbashkët dhe të këmbëjnë informatat e domosdoshme për implementimin e projekteve.


- IV. Oda e Avokatëve të Kosovës në Prishtinë dhe Kolegji FAMA, si partnerë të përbashkët mund të hyjnë veç e veç në raporte kontraktuese me partnerë të tjerë dhe mund të mbështesin anëtarët dhe klientët e partnerëve si dhe projektet e tyre me qëllim të krijimit të një partneriteti të frytshëm dhe koperues në mes tyre.
- V. Oda e Avokatëve të Kosovës në Prishtinë dhe Kolegji FAMA, pajtohen që për nevojat e tyre të shkëmbejnë ekspertët dhe përvojat e tyre në fushat e caktura.
- VI. Oda e Avokatëve të Kosovës në Prishtinë dhe Kolegji FAMA, së bashku do të bashkëpunojnë për organizimin e konferencave me karakter ndërkombëtar nga fusha Marrëdhënieve Ndërkombëtare.
- VII. Oda e Avokatëve të Kosovës në Prishtinë dhe Kolegji FAMA, pajtohen se do t'iu ofrojnë partneritet insitucioneve qeveritare vendore dhe atyre ndërkombëtare me qëllim të avancimit dhe ngritjes së standardeve drejt integritit të vendit ne Bashkimin Evropian.
- VIII. Specifikat e realizimit të praktikës së studentëve të Kolegjit FAMA (si: numrin e studentëve, kohën etj.), do të specifikohet me një aneks mbi bazën e kësaj marreveshjeje në mes përfaqësuesve të insitucioneve.
- IX. Ky memorandum i mirëkuptimit hynë në fuqi ditën e nënshkrimit të tij, memorandumi do të katë afat të pakufizuar, përderisa njëra palë me shkrim nuk e njoftonë palën tjetër 6 muaj më parë, për ndryshimet eventuale.
- X. Ky Memorandum i Mirëkuptimit për bashkëpunim nënshkruhet në gjuhën shqipe dhe për secilën palë përgatitet nga një kopje origjinale.

**Kryetari i Odës së Avokatëve të Kosovës**



**Av. Ibrahim Z. Dobruna**

**Rektori i Kolegjit FAMA**



**Prof. Dr. Frashër Demaj**

**Më datë, 09 Qershor 2014**